është Zilota polake, monedha zyrtare e Republikës së Polonisë.

është INTER CARS S.A., me seli në Varshavë, ul. Poësińska 64, 02-903 Warszawa, e regjistruar në regjistrin e shoqërive i mbajtur nga Gjykata Rajonale e Varshavës në Varshavë, XIII Departamenti Ekonomik për Regjistrin e Gjykatës Kombëtare, numër KRS 0000008734, NIP: 1181452946, REGON: 014992887, apo në të ardhmen, çdo person fizik a juridik i regjistruar në regjistrin e anëtarëve të shoqërisë si zotërues aksionesh në shoqëri dhe “aksionari” do të interpretohet sipas rastit.

Neni 2 – Forma ligjore

- 2.1 Shoqëria është themeluar si shoqëri aksionare në Republikën e Shqipërisë dhe është e organizuar dhe funksionon në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare.

Neni 3 - Selia


- 3.1 Selia e shoqërisë është: Rr. “Ibrahim Rugova”, Sky Tower, Kati 5, Ap. 2, Tiranë, Shqipëri.

Neni 4 – Emri dhe kohëzgjatja

- 4.1 Emri i shoqërisë është “Inter Cars Albania” SHA. Emri tregtar i shoqërisë do të jetë Inter Cars Albania.
- 4.2 Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një periudhë të pakufizuar.

Neni 5 – Objekti i aktivitetit

- 5.1 Aktiviteti i shoqërisë do të përfshijë, por pa u kufizuar në, si vijon: import-export, shpërndarje, shitje me shumicë dhe pakicë të pjesëve të ndryshme të këmbimit për mjetet motorike, pajisje për serviset e riparimit, bateri, të gjitha llojet e gomave dhe çdo produkt ose aksesori i lidhur me mjetet motorike të çdo lloji dhe tipi, mallra industriale etj; import, export, shpërndarje, shitje me shumicë dhe pakicë të naftës bruto dhe të gjitha nënprodukteve të saj si vajra, lubrifikantë etj.
- 5.2 Për të përmbushur qëllimin e lartpërmendur, Shoqëria mund gjithashtu të:
- kryejë çdo aktivitet me aktive të prekshme dhe të paprekshme, si dhe veprimtari tregtare, qiradhënie ose hipotekore që mund të konsiderohen të përshtatshme ose të nevojshme për të përmbushur qëllimin e Shoqërisë;
 - blejë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, pasuri të luajtshme ose të paluajtshme dhe interesa në shoqëri të tjera që kanë një qëllim të ngjashëm me shoqërinë, në Shqipëri ose jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë dhe



- ushtrojë çdo aktivitet tjetër që mund të konsiderohet i përshtatshëm ose i nevojshëm për përmbushjen e qëllimit të Shoqërisë.

5.3 Shoqëria mund të kryejë gjithashtu çdo biznes ose aktivitet tjetër që konsiderohet nga Asambleja e Përgjithshme se është zhvilluar ose kryer në mënyrë të përshtatshme ose të favorshme në lidhje me ndonjë nga objektet e mësipërme ose që është llogaritur në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë për të rritur vlerën ose për ta bërë më fitimprurës cilindo nga Aktivitetet Tregtare, pasurinë ose të drejtat e Shoqërisë, në përputhje me legjislacionin shqiptar; dhe në përgjithësi të kryejë të gjitha veprimet e tjera që Shoqëria mund të gjykojë si të rastësishme ose të favorshme për arritjen e objektivave të mësipërm ose ndonjë prej tyre.

KAPITULLI II

KAPITALI; AKSIONET DHE NDRYSHIMI I TË DREJTAVE

Neni 6 – Kontributet

- 6.1 Kapitali fillestar i regjistruar i shoqërisë është 3.500.000,00 (tre milionë e pesëqind mijë) lekë , i ndarë në 3,500 (tre mijë e pesëqind) aksione të zakonshme me vlerë nominale prej 1,000 (një mijë) lekë secili (në vijim referuar bashkërisht si “Aksione”). Kapitali fillestar do të paguhet plotësisht në para përpara regjistrimit, në llogarinë bankare të përkohshme të Shoqërisë.
- 6.2 Struktura aksionare e Shoqërisë është si më poshtë:

Aksionari	Nr. i Aksioneve të zakonshme	Vlera nominale e Aksioneve të zakonshme (ALL)	Vlera totale e shprehur në kapital (ALL)	Përqindje e kapitalit aksionar
Inter Cars S.A.	3,500	1,000	3,500,000	100 %

- 6.3 Shoqëria nuk mund të emetojë aksione të reja si pasojë e zmadhimit të kapitalit në rast se kontributet e mëparshme nuk janë paguar tërësisht.
- 6.4 Nëse aksionari nuk paguan kontributet përkatëse kur ato bëhen të pagueshme, neni 124 i Ligjit për Shoqëritë Tregtare do të zbatohet.

Neni 7 – Zmadhimi i kapitalit

- 7.1 Zmadhimi i kapitalit kryhet sipas mënyrave dhe në përputhje me procedurat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare ose sipas vendimit të Asamblesë së Përgjithshme për aq sa është në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare.

- 7.2 Asambleja e Përgjithshme do të përcaktojë datat në të cilat kontributi për zmadhimin e kapitalit do të bëhet i pagueshëm ose do t'i delegojë Administratorit detyrën për të përcaktuar mënyrën, kohën dhe metodën e pagesës për këtë kontribut.
- 7.3 Nëse Shoqëria ka më shumë se një Aksionar, aksionarët kanë të drejtë parablerjeje në lidhje me nënshkrimin e aksioneve të pagueshme në para të emtuara për zmadhimin e kapitalit. Kjo e drejtë është në përpjesëtim me aksionet e zotëruara nga secili aksionar përpara zmadhimit të kapitalit. Aksionarët mund të heqin dorë personalisht nga e drejta e tyre për të nënshkruar aksione të reja.
- 7.4 Në rast se zmadhimi i kapitalit bëhet në natyrë, me vendim gjykate caktohet një vlerësues për të vlerësuar kontributet në natyrë sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare.
- 7.5 Nëse aksionarët dështojnë të paguajnë kontributin përkatës kur ato bëhen të pagueshme, do të zbatohet neni 124-i Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

Neni 8 – Zvogëlimi i kapitalit


- 8.1 Zvogëlimi i kapitalit kryhet sipas mënyrave dhe në përputhje me procedurat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare ose sipas vendimit të Asamblesë së Përgjithshme për aq sa është në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare, por në çdo rast zvogëlimi i kapitalit prek aksionarët në bazë proporcionale.
- 8.2 Këshilli i Administrimit duhet t'i paraqesë Asamblesë së Përgjithshme një raport gjithëpërfshirës për zvogëlimi e kapitalit, duke specifikuar rrethanat për të cilat kërkohet zvogëlimi i kapitalit.

Neni 9 – Të drejtat dhe detyrimet e lidhura me Aksionet

- 9.1 Aksionet e zakonshme u japin zotëruesve të tyre:
- (i) të drejtën për t'u njoftuar si dhe për të marrë pjesë e votuar në të gjitha mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë dhe për të ushtruar çdo të drejtë tjetër lidhur me aksionet sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare; dhe
 - (ii) të drejtën për të marrë dividendë ose shpërndarje të tjera në përpjesëtim me vlerën e aksioneve në kapitalin aksionar të shoqërisë (nëse Asambleja e Përgjithshme vendos kështu).
- 9.2 Aksionarët janë përgjegjës deri në kufirin e vlerës nominale të aksioneve të papaguara.
- 9.3 Të drejtat dhe detyrimet e secilit aksion ndjekin aksionin në mënyrë të pavarur nga transferimi ose formës së transferimit.

Neni 10 – Regjistri i Aksioneve

- 10.1 Administratori do të mbajë një regjistër në të cilin regjistrohen emrat dhe adresat e Aksionarit të Vetëm ose të gjithë aksionarëve të tjerë, nëse zbatohet, i përcakton datën e blerjes së Aksioneve, numrin, klasën e emërimitin e tyre (nëse ka) dhe shumën e paguar për çdo aksion. Emrat dhe adresat



e palëve që kanë një Barrë lidhur me Aksionet e Shoqërisë duhet të regjistrohen në regjistër, duke përcaktuar datën kur e kanë fituar të drejtën dhe të drejtat bashkëngjitur Aksioneve të cilat u janë dhënë atyre.

- 10.2 Aksionarët dhe palët e tjera, të dhënat e të cilëve regjistrohen sipas paragrafit 1 të këtij neni, duhet t'i japin Administratorit brenda kohës së duhur të dhënat e kontaktit të kërkuara. Nëse njoftohet një adresë elektronike, qoftë dhe me qëllimin për t'u regjistruar në Regjistrin e Aksioneve, atëherë njoftimi përbën edhe pëlqim për t'i marrë të gjitha njoftimet e deklaratat lidhur me thirrjen e mbledhjeve, në formë elektronike përmes adresës së dhënë.
- 10.3 Regjistri duhet të përditësohet rregullisht. Pronari i ligjshëm i një aksioni prezumohet të jetë personi i regjistruar në regjistrin e aksioneve.
- 10.4 Administratori duhet ta vë në dispozicion regjistrin në zyrën e Shoqërisë për inspektim nga Aksionarët, uzufruktarët dhe pengmarrësit të cilët kanë fituar të drejta me ose pa posedim mbi Aksionet. Me paraqitjen e kërkesës, Administratori duhet t'u sigurojë ekstrakte të regjistrit personave të përmendur në këtë paragraf.

Neni 11 – Transferimi i Aksioneve

- 11.1 Aksionari i vetëm është pronari ekskluziv i të gjitha aksioneve të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë.
- 11.2 Aksionari mund të transferojë lirisht një ose të gjitha aksionet e tij me marrëveshje me shkrim.
- 11.3 Aksionet e kapitalit të regjistruar transferohen nëpërmjet trashëgimit pa ndonjë marrëveshje të veçantë.

KAPITULLI III

STRUKTURA E SHOQËRISË

Neni 12 – Struktura e shoqërisë

- 12.1. Shoqëria është e strukturuar si shoqëri aksionare me një nivel dhe me këto organe shoqërie:
 - a. Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve;
 - b. Këshilli i Administrimit; dhe
 - c. Administratori(ët).

Neni 13 – Asambleja e Përgjithshme

- 13.1 Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë i Shoqërisë dhe ka të drejtë të marrë vendime për të gjitha çështjet e Shoqërisë në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare. Ajo ka të drejtë të

shqyrtojë vlefshmërinë e çdo vendimi të organeve të Shoqërisë dhe, nëse është e nevojshme, t'i anulojë ato në rast papajtueshmërie me statutin dhe Ligjin për Shoqëritë Tregtare. Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose fshihen. Për sa kohë që ka vetëm një aksionar në Shoqëri, vendimet e Aksionarit të Vetëm do të jenë në formën e një dokumenti të vetëm të nënshkruar nga Aksionari i Vetëm dhe nuk do të mbahet procesverbal.

13.2 Të drejtat dhe detyrimet e Aksionarit të Vetëm të Shoqërisë ushtrohen drejtpërdrejt nga përfaqësuesi i Aksionarit të Vetëm ose nga çdo person i caktuar nga ai në përputhje me ligjet e vendit në të cilin ndodhet Aksionari i Vetëm.

13.3 Asambleja e Përgjithshme vendos për çështjet e mëposhtme:

- a. përcaktimi i politikave tregtare;
- b. ndryshimet në statut;
- c. emërimi dhe shkarkimi i anëtarëve të Këshillit të Administrimit;
- d. emërimi dhe shkarkimi i audituesve të pavarur dhe likuiduesve;
- e. miratimi i skemës së shpërblimit të anëtarëve të Këshillit të Administrimit, audituesve dhe likuiduesve;
- f. miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- g. shpërndarja e fitimeve vjetore;
- h. zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit;
- i. pjesëtimi i aksioneve dhe anulimi i tyre;
- j. ndryshimet në të drejtat që lidhen me aksione të llojeve e kategorive të veçanta; ;
- k. përfaqësimi i Shoqërisë përpara gjykatës dhe në procedura të tjera kundrejt organeve drejtuese;
- l. ristrukturimi dhe prishja e shoqërisë;
- m. miratimi i rregullave të veta procedurale;
- n. çështjet specifike të përcaktuara në nenin 13.4.

13.4 Pavarësisht dispozitave të kundërta në këtë Statut, çdo veprim ose transaksion për ndonjë nga çështjet e listuara më poshtë do t'i nënshtrohet dhe kërkon miratimin paraprak të Asamblesë së Përgjithshme:

- a. marrja përsipër e detyrimeve dhe disponimi i të drejtave të pronësisë, pavarësisht nga shuma e këtyre detyrimeve, me objekt:
 - i. marrja e kredive dhe lehtësirave të kredisë, si dhe marrja e çdo borxhi tjetër financiar,
 - ii. emetimi i obligacioneve dhe instrumenteve të tjera të borxhit,
 - iii. vendosja e hipotekave, barrëve dhe formave të tjera të sigurimit,
 - iv. dhënie e deklaratave ose garancive (duke përjashtuar ato që rezultojnë nga detyrimet e Aksionarit të Vetëm),
 - v. emetimin, garantimin dhe miratimin e kambialit,
 - vi. blerjen, shitjen ose disponimin në çdo formë tjetër të titullit mbi një pronë të paluajtshme, uzufuktit të përhershëm (ose të drejte të ngjashme) të një pasurie të paluajtshme ose të një pjese në një pasuri të paluajtshme,

- vii. blerjen, shitjen ose disponimin në çdo formë tjetër të aksioneve të shoqërive të tjera, riblerjen e aksioneve, dhënien e kontributeve në para dhe në natyrë për shoqëritë dhe nënshkrimin e aksioneve,
- viii. shitjen ose disponimin në çdo formë tjetër të markave tregtare ose të drejtave të tjera të pronësisë industriale (përfshirë dhënien e licencave ekskluzive);
- duke përjashtuar veprimet ku pala tjetër është Aksionari i Vetëm.

- b. marrja përsipër e detyrimeve dhe disponimi i të drejtave të pronësisë që tejkalojnë ekuivalentin e EUR 250,000 (ose çdo shumë tjetër ekuivalente të shprehur në PLN, ALL ose një monedhë tjetër), duke përjashtuar: (i) marrëveshjet tregtare dhe veprimet ku pala tjetër është Aksionari i Vetëm ose furnizuesit e Aksionarit të Vetëm; ose (ii) marrëveshjet tregtare në lidhje me mallrat, të drejtat ose shërbimet që janë objekt i ofertës tregtare të Shoqërisë.
- c. kryerja e aktiviteteve pa pagesë, duke përfshirë dhënien e donacioneve dhe huapërdorjeve; dhe
- d. financimi, bashkimi dhe mbyllja e shoqërive, ndërmarrjeve, degëve dhe zyrave të përfaqësimit, miratimin e udhëzimeve në lidhje me mënyrën e votimit në mbledhjen e aksionarëve ose në mbledhjen e përgjithshme të shoqërive me shoqërinë zotëruese të aksioneve të një filiali (*shareholding company*).

- 13.5 Asambleja e Përgjithshme ka të drejtë të vendosë për çdo çështje shtesë e cila nuk është shprehimisht kompetencë e ndonjë organi tjetër sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare ose këtij statuti.

Neni 14 – E drejta e informimit


- 14.1 Administratori i Shoqërisë është i detyruar t'i vë në dispozicion në çdo kohë Aksionarit të Vetëm të gjithë informacionin e dhënë në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

Neni 15 – Këshilli i Administrimit

- 15.1 Shoqëria do të administrohet nga Këshilli i Administrimit i cili është organi ekzekutiv i Shoqërisë (modeli me një nivel). Anëtarët e Këshillit emërohen për një mandat jo më të gjatë se 3 (tre) vjet, siç përcaktohet në vendimin për emërimin e tyre. Këshilli ka të drejtë të ushtrojë secilën nga kompetencat sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare, si dhe kompetencat shtesë të parashikuara në këtë Statut.

15.2 Kompetencat e Këshillit të Administrimit

- a. Përveç kompetencave që i janë dhënë në mënyrë të shprehur Këshillit sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare të përcaktuara më poshtë, Këshilli gjithashtu ka të drejtë të vendosë mbi çdo çështje të përcaktuar në Shtojcën A – Çështjet e Rezervuara të Këshillit të këtij statuti:
- i. të japë direktiva për Administratorin për zbatimin e politikave tregtare të Shoqërisë;
 - ii. të kontrollojë e të mbikëqyrë zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë nga Administratori;

- 
- iii. të përgatisë, me kërkesë të asamblesë së përgjithshme, marrjen e masave, që janë në kompetencë të kësaj të fundit, t'i rekomandojë asaj vendime të nevojshme për t'u marrë, si dhe të zbatojë vendimet e asamblesë;
 - iv. të thërrasë mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, sa herë vlerësohet e nevojshme për interesat e Shoqërisë;
 - v. të kujdeset që Shoqëria të respektojë ligjin dhe standardet e kontabilitetit;
 - vi. të shqyrtojë e të kontrollojë librat kontabël, dokumentet dhe aktivet e Shoqërisë;
 - vii. të sigurojë se pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurisë së veprimtarisë, si dhe detyrimet e tjera të raportimit e publikimit, të përgatiten dhe kryhen me saktësi nga Administratori dhe të miratohen e të nënshkruhen nga Këshilli i Administrimit përpara se t'i paraqiten Asamblesë së Përgjithshme, se bashku me raportin e mbikëqyrjes së Këshillit të Administrimit;
 - viii. të sigurojë se auditimi i librave dhe i regjistrimeve kontabël të kryhet të paktën një herë në vit nga një Auditues i pavarur, dhe raporti i auditimit, drejtuar Asamblesë së Përgjithshme, t'u vihet në dispozicion të gjithë anëtarëve të Këshillit të Administrimit. Raporti i Këshillit të Administrimit, përmendur në numrin vii. më sipër, duhet të përmbajë edhe mendimin e Këshillit të Administrimit për raportin e auditimit;
 - ix. të emërojë dhe shkarkojë Administratorin dhe të përcaktojë tagrat e tyre;
 - x. të përcaktojë shpërblimin e Administratorit;
 - xi. të miratojë marrjen përsipër borxheve të Shoqërisë si hua, emetim obligacionesh ose instrumente të tjera borxhi të konvertueshme, që përmbajnë më shumë se 5% të asetëve të Shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare;
 - xii. të vendosë krijimin e bashkëpunimeve tregtare afatgjata dhe propozimin e politikave për themelimin e shoqërive tregtare ose të grupeve të reja;
 - xiii. të kryejë veprime të tjera, të përcaktuara në ligj ose në Statut.
- b. Gjatë ushtrimit të kompetencave të tij, Këshilli është i autorizuar t'u përmbahet parimeve të mëposhtme:
- a. sigurimin e interesit të Shoqërisë;
 - b. trajtimin e çështjeve të Shoqërisë duke pasur parasysh interesin e Inter Cars CG;
 - c. zbatimin dhe respektimin e standardeve të Inter Cars CG;
 - d. t'i ofrojë Aksionarit të Vetëm informacion mbi aktivitetet e Shoqërisë brenda kohës dhe fushëveprimit të specifikuar nga Aksionari i Vetëm, duke i mundësuar atij që:
 - i. të pajtohet me detyrimet për komunikimin të vendosur për shoqëritë me ofertë publike, aksionet e të cilave janë të listuara në tregun e rregulluar të Bursës së Varshavës; dhe

ii. të sigurojë përputhjen e aktiviteteve të Inter Cars CG me detyrimet që rrjedhin nga dokumentacioni në lidhje me financimin e marrë nga Aksionari i Vetëm dhe Inter Cars CG;

e. arritjen e objektivave dhe kryerjen e detyrave të përcaktuara nga Inter Cars CG.

c. Kompetencat e Këshillit mund të ndryshohen herë pas here me anë të një vendimi të Asamblesë së Përgjithshme. Çdo ndryshim në çështjet e rezervuara të Këshillit nuk do të interpretohet si një ndryshim i këtij Statuti.

15.3 Përveç nëse një shumicë më e madhe kërkohet nga Ligji për Shoqëritë Tregtare, çdo çështje në kompetencën e Këshillit do të miratohet me:

- (i) një vendim i Këshillit të marrë me shumicë të thjeshtë në një mbledhje të Këshillit me numrin e duhur të pjesëmarrësve për të marrë vendime; ose
- (ii) një vendim unanim me shkrim i të gjithë anëtarëve të Këshillit.

Miratimi në përputhje me këtë nen nuk kërkohet për asnjë çështje që është kompetencë e Asamblesë së Përgjithshme sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare ose këtij statuti dhe është miratuar tashmë nga Asambleja e Përgjithshme me shumicë të thjeshtë, përveç rasteve kur kërkohet shumica e cilësuar në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare.

15.4 Përbërja e Këshillit

Këshilli përbëhet nga tre (3) anëtarë ose më tepër, në përputhje me vendimin e Aksionarit të Vetëm, të emëruar për një mandat tre (3) vjeçar të rinovueshëm, ku secili ka kualifikimet dhe përvojën e mjaftueshme për të menaxhuar dhe mbikëqyrur menaxhimin e Shoqërisë. Drejtori Menaxhues/Administratori mund të jetë gjithashtu anëtar i Këshillit të Administrimit.


15.5 Emërimi dhe shkarkimi i anëtarëve të Këshillit

a. Çdo emërim ose revokim i një anëtari të Këshillit bëhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme ose nëpërmjet vendimit me shkrim të Aksionarit, dhe një emërim ose shkarkim i tillë do të hyjë në fuqi në përputhje me termat e këtij vendimi ose vendimi me shkrim.

b. Në rast të një pozicioni të lirë, Administratori ose çdo anëtar i Këshillit duhet të njoftojë menjëherë Aksionarin.

c. Arsye të vlefshme për revokimin e një Anëtari të Këshillit konsiderohet që janë të mëposhtmet:

- i. Vdekja;
- ii. paaftësia për shkak të sëmundjes fizike ose mendore;
- iii. dorëheqja;

- 
- iv. sjellje të pahijshme ose veprim në kundërshtim me udhëzimet e Asamblesë së Përgjithshme; ose
 - v. çdo shkelje e dispozitave të Statutit ose Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

15.6 Kryetari dhe Nënkryetari i Këshillit

- a. Përveç kryetarit të parë dhe nënkryetarit të Këshillit të cilët emërohen në këtë Statut dhe do të ratifikohen përkatësisht në mbledhjen e parë të Këshillit të Administrimit, kryetari dhe nënkryetari i radhës i Këshillit do të zgjidhet dhe emërohet ndërmjet dhe midis anëtarëve të Këshillit të Administrimit. Kryetari do të shërbejë si kryesues i mbledhjeve të Bordit sa herë që ai është i pranishëm dhe do të ketë një votë vendimtare.
- b. Nënkryetari kryen funksionet e kryetarit në çdo mbledhje në të cilën kryetari nuk është i pranishëm dhe ka një votë vendimtare.

Neni 16 – Procedurat e Këshillit

16.1 Thirrja e mbledhjeve të Këshillit

Çdo Anëtar i Këshillit mund të thërrasë një mbledhje të Këshillit në çdo kohë. Anëtarët e Këshillit do t'i mbajnë mbledhjet e Këshillit në selinë e Shoqërisë ose në një vend tjetër që të gjithë anëtarët e Këshillit mund të zgjedhin ose nëpërmjet mjeteve elektronike. Këshilli do të mbledhet të paktën katër herë në vit dhe të paktën një herë në tre muaj.

16.2 Njoftimi i mbledhjeve të Këshillit

Çdo anëtar i Këshillit do t'i jepet një njoftim me shkrim të paktën 2 (dy) Ditë Pune përpara për një mbledhje të Këshillit, përveç nëse anëtarët e Këshillit miratojnë me shkrim një periudhë më të shkurtër njoftimi. Një njoftim i tillë do të shoqërohet me rendin e ditës që identifikon në hollësi të arsyeshme çështjet që do të diskutohen në mbledhje së bashku me kopjet e çdo dokumenti përkatës që do të diskutohet në mbledhje.

16.3 Kuorumi në mbledhjet e Këshillit

- a. Kuorumi për marrjen e vendimeve në çdo mbledhje të Këshillit (përfshirë Mbledhjen e Shtyrë të Këshillit) duhet të jetë të paktën dy (2) Anëtarë të Bordit. Nëse kuorumi nuk është i pranishëm brenda 60 minutave nga koha kur mbledhja duhet të kishte filluar ose nëse gjatë mbledhjes nuk ka më kuorum, mbledhja do të shtyhet dhe do të mbledhet në të njëjtën kohë dhe vend në ditën e punës që bie dy (2) Ditë Pune menjëherë pas datës së propozuar të mbledhjes, përveç nëse të gjithë Anëtarët e Këshillit bien dakord me shkrim për një periudhë tjetër

(“Mbledhja e Shtyrë e Bordit”). Njoftimi për mbledhjen e shtyrë të Bordit do t'u jepet anëtarëve të Bordit që mungojnë.

- b. Çdo Anëtar i Këshillit ka të drejtë të ftojë, sipas gjykimit të tij, deri në dy (2) persona në çdo mbledhje të Bordit. Kuptohet që këta persona nuk kanë të drejtë të votojnë në mbledhje.

16.4 Procesverbali dhe vendimet e Këshillit

Anëtarët e Këshillit marrin vendime duke i miratuar ato. Procesverbali i mbledhjes mbahet dhe nënshkruhet nga kryetari. Ekstraktet e vendimeve të miratuara në mbledhjet e Këshillit, të kërkuara për depozitim, do të nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e Këshillit të pranishëm në një mbledhje të Këshillit. Nëse ndonjë anëtar i Këshillit refuzon të nënshkruajë ekstraktin, ai do të konsiderohet si një ekstrakt i vërtetë i vendimeve të miratuara në mbledhje me nënshkrimin e vetëm të kryetarit.

16.5 Pjesëmarrja në mbledhjet e Këshillit

Një anëtar i Këshillit mund të marrë pjesë në një mbledhje të Këshillit me anë të telefonit, videokonferencës ose pajisjeve të ngjashme të komunikimit që u mundëson të gjithë personave që marrin pjesë në mbledhje të dëgjojnë dhe flasin me njëri-tjetrin gjatë gjithë mbledhjes. Një person që merr pjesë në këtë mënyrë konsiderohet të jetë i pranishëm personalisht në mbledhje dhe numërohet në kuorum dhe ka të drejtë vote.

16.6 Vendndodhja e mbledhjeve të Këshillit

Nëse të gjithë anëtarët e Këshillit që marrin pjesë në një mbledhje nuk janë në të njëjtin vend dhe nëse nuk bien dakord ndryshe, atëherë mbledhja do të konsiderohet si e zhvilluar në selinë e Shoqërisë.

16.7 Vendimet me shkrim të Këshillit

Këshilli i Administrimit mund të vendosë nëpërmjet vendimit me shkrim pa thirrur mbledhjen e Këshillit, me kusht që të gjithë anëtarët e Këshillit të votojnë në favor të një vendimi të tillë. Njoftimi për një vendim të propozuar të Këshillit duhet t'i jepet me shkrim secilit Anëtar të Këshillit. Pavarësisht nga ndonjë dispozitë tjetër e këtij Statuti, një vendim me shkrim i Këshillit miratohet kur secili nga anëtarët e Këshillit ka votuar në favor të një vendimi të tillë dhe ka nënshkruar një ose më shumë kopje të saj, dhe me kusht që asnjë anëtar i Këshillit të mos kërkojë diskutime rreth vendimit të propozuar. Pasi të jetë miratuar një vendim me shkrim i Këshillit, ai do të trajtohet sikur të ishte një vendim i marrë në një mbledhje të Këshillit në përputhje me këtë statut.

Neni 17 – Administratori



- 17.1 Shoqëria do të ketë një ose më shumë Administrator, i cili do të kenë kompetenca për të drejtuar aktivitetet e përditshme të Shoqërisë në drejtimin dhe mbikëqyrjen e përgjithshme të Këshillit të Administrimit në përputhje me Çështjet e Rezervuara të Këshillit, nëse ka, Statutit dhe Ligjit për Shoqëritë Tregtare.
- 17.2 Administratori mund të veprojë individualisht ose, nëse emërohet më shumë se një, do të veprojnë së bashku dhe do ta përfaqësojnë Shoqërinë para palëve të treta, me kusht që të merret miratimi paraprak me shkrim nga Asambleja e Përgjithshme ose e Këshillit të Administrimit për çdo çështje në kompetencën e Asamblesë së Përgjithshme ose Këshillit të Administrimit në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare, këtë Statut ose që përbën një çështje të rezervuar të Këshillit. Për qëllim përfaqësimi të Shoqërisë, çdo veprim i Administratorit që kërkon miratim paraprak me shkrim të Asamblesë së Përgjithshme ose të Këshillit do të konsiderohet si i miratuar rregullisht dhe ka vlerë kundrejt palëve të treta nëse shoqërohet me deklaratë me shkrim, konfirmim ose kundër-firmë, sipas rastit, të përfaqësuesit të Aksionarit të Vetëm ose vetëm të Kryetarit të Këshillit. Çdo Administrator mund t'i delegojë me prokurë secilën nga kompetencat e tij administratorëve të tjerë ose palëve të treta.
- 17.3 Administratori është i detyruar të ruajë si konfidencial informacionin e Shoqërisë që ka marrë gjatë ushtrimit të detyrës së tij dhe të kryejë detyrat e tij në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare. Kur Administratori, si rezultat i veprimeve ose mosveprimeve të tij, në kundërshtim me Ligjin për Shoqëritë Tregtare ose me këtë statut, i shkakton Shoqërisë një dëm material ose moral, ai mban përgjegjësi për dëmin e shkaktuar.
- 17.4 Kompetencat e administrimit dhe përfaqësimit të çdo Administratori dhe çdo kufizim i tyre, mund të përcaktohen dhe/ose të ndryshohen me vendim të Këshillit të Administrimit të Shoqërisë të miratuar kohë pas kohe dhe një ndryshim i tillë nuk do të interpretohet si ndryshim i këtij Statuti. Për më tepër, çështjet që përbëjnë çështje të rezervuara të Këshillit, nëse ka dhe nëse janë të zbatueshme, do të interpretohen si kufizim i kompetencave të Administratorëve dhe do të regjistrohen si të tilla në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- 17.5 Shpërblimi i Administratorit përcaktohet me vendim të Këshillit të Administrimit.
- 17.6 Administratori emërohet për një periudhë ose një mandat jo më të gjatë se 3 (tre) vite, siç përcaktohet në vendimin për emërimin e tyre, me miratim nga Këshilli me shumicë të thjeshtë. Shkarkimi i drejtorit ekzekutiv vendoset me vendim të Këshillit të miratuar me shumicë të thjeshtë. Kur Administratori është në të njëjtën kohë anëtar i Këshillit të Administrimit, ai nuk do të marrë pjesë në procesin e votimit.
- 17.7 Çdo referencë e Administratorit në këtë Statut, duhet të interpretohet si referencë ndaj cilitdo prej Administratorëve të Shoqërisë, nëse është emëruar më shumë se një i tillë.

Neni 18 – Detyrimi i Besnikërisë dhe Përgjegjësia

- 18.1 Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 13, 14, 15, 17 e 18, 163 dhe 164 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare, secili prej Anëtarëve të Këshillit dhe Administratori (ët) duhet të:
- kryejnë detyrat e tij të përcaktuara në Ligjin për Shoqëritë Tregtare, këtë Statut apo vendimet e Asamblesë së Përgjithshme në mirëbesim e në interesin më të mirë të Shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së Shoqërisë në mjedis;
 - ushtrojnë kompetencat që i njihen nga Ligji për Shoqëritë Tregtare, ky Statut ose vendimet e Asamblesë së Përgjithshme, vetëm për qëllimet e përcaktuara në këto dispozita;
 - vlerësojnë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
 - parandalojnë dhe mënjanojnë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale, interesave të Personave të Lidhur dhe ato të Shoqërisë;
 - ushtrojnë kujdesin e duhur të një biznesmeni të besueshëm dhe të ndërgjegjshëm dhe ruajnë fshehtësinë për çështjet konfidenciale;
 - sigurojnë çdo informacion në lidhje me Biznesin dhe informacionet ekonomike të kërkuara nga çdo Ortak brenda një kohe të arsyeshme dhe në çdo rast jo më vonë se 7 (shtatë) ditë. Informacioni dhe të dhënat duhet të jenë të përditësuara.
- 18.2 Secili prej Anëtarëve të Këshillit dhe Administratori(ët) në kryerjen e detyrave të tyre do të mbajnë përgjegjësi ndaj Shoqërisë për një veprim ose mosveprim që lidhet në mënyrë të arsyeshme me objektin e Shoqërisë, përveç rasteve kur, në bazë të një hetimi dhe vlerësimi të informacionit përkatës, veprimi ose mosveprimi ka qenë në mirëbesim.
- 18.3 Në rast shkelje të detyrimeve dhe standardeve të kujdesit që referohen në këtë nen, ose në shkelje të Ligjit për Shoqëritë Tregtare, këtij Statuti ose vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme, Anëtarët e Këshillit dhe Administratori do të ketë detyrimin për të kompensuar Shoqërinë për çdo dëm që rezulton nga shkelja. Ai/ajo do të kthejë çdo përfitim personal të marrë nga ai apo persona të lidhur gjatë shkeljes së detyrimeve të tij. Ai/Ajo do të ketë barrën e provës për të provuar përmbushjen e detyrimeve të tij dhe standardeve të kërkuara. Kur një shkelje është kryer nga më shumë se një person, të gjithë personat në fjalë do të jenë përgjegjës bashkërisht dhe veçmas ndaj Shoqërisë.

KAPITULLI IV

AUDITIMI DHE ÇËSHTJET FINANCIARE

Neni 19 – Kontabilisti

- 19.1 Shoqëria ka të paktën një kontabilist të përhershëm, i cili duhet të flasë dhe të shkruajë anglisht, i emëruar nga Këshilli i Administrimit dhe që përmbush detyrat në lidhje me këtë pozicion.

- 19.2 Kontabilisti ruan konfidencialitetin e informacionit që merr gjatë ushtrimit të detyrave të tij profesionale dhe mban përgjegjësi për dëmin që i është shkaktuar shoqërisë për shkak të veprimeve ose mosveprimeve të tij të gabuara.

Neni 20 – Audituesi

- 20.1 Asambleja e Përgjithshme do të emërojë, me shumicë të thjeshtë, një auditues, për çdo vit financiar me kompetencat e mëposhtme, por jo vetëm:
- të ndihmojë në mbajtjen e llogarive në mënyrë që të jenë në përputhje me parimet e kontabilitetit;
 - të përgatisë raportin e auditorit dhe dokumentet tjera në përputhje me dispozitat ligjore; dhe
 - të informojë Administratorin dhe Këshillin e Administrimit për çdo parregullsi të konstatuar në procedurat, aktivet ose llogaritë e shoqërisë ose në çdo çështje tjetër që lidhet me të dhënat financiare të shoqërisë.

Neni 21 – Librat e shoqërisë

- 21.1 Shoqëria do të mbajë libra dhe do të përgatisë dokumente që regjistrojnë llogaritë vjetore, pasqyrat financiare, bilancet, raportet financiare dhe çdo dokument tjetër të tillë, siç kërkohet me ligj.
- 21.2 Librat e Shoqërisë dhe pasqyrat financiare vjetore, bilancet dhe raportet financiare do të mbahen në gjuhën angleze dhe shqipe; dhe të shprehura në euro (EURO) dhe në lekë (LEKË).

Neni 22 – Viti financiar

- 22.1 Viti financiar fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor të çdo viti, me përjashtim të vitit të parë financiar që përfshin periudhën kohore nga regjistrimi fillestar në Regjistrin Tregtar deri më 31 dhjetor.

Neni 23 – Rezerva

- 23.1 Të paktën 5% e fitimit neto pas zbritjes së humbjeve të viteve të mëparshme mbahet si rezervë e detyrueshme. Shpërndarja e fitimeve në rezervën e detyrueshme nuk është me e detyrueshme kur kjo rezervë arrijn shumën e 1/10 (një të dhjetës pjesë) të kapitalit themeltar, por do të rifillojë në rast se rezerva e domosdoshme bie nën 1/10 (një të dhjetën pjesë) të kapitalit.

KREU V

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 24 – Likuidimi i shoqërisë

- 24.1. Pas vendimit për prishjen e shoqërisë, Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë likuidues dhe përcakton kompetencat e tyre dhe mënyrën e likuidimit të shoqërisë, në përputhje me dispozitat përkatëse të ligjit për shoqëritë tregtare.
- 24.2. Likuiduesi ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me ligjin për shoqëritë tregtare dhe ushtron kompetencat drejtuese dhe përfaqësuese të shoqërisë, të përcaktuara në vendimin e Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 25 – Anëtarët e Parë të Këshillit të Administrimit


- 25.1. Kryetari i parë dhe nënkryetari i Këshillit do të zgjidhen dhe emërohen nga Anëtarët e Këshillit më poshtë në këtë Statut dhe emërimi i tyre do të ratifikohet përkatësisht në mbledhjen e parë të anëtarëve të Këshillit të Administrimit. Anëtarët e parë të Këshillit të Administrimit emërohen për një mandat 3 (tre) vjeçar janë:
- **Z. Marius Mujdei**, me nr. pasaporte 058884308, lindur më 19.02.1978 në Borca, Rumani, shtetas rumun, kryetar i Këshillit të Administrimit;
 - **Z. Charalampos Christidis**, me nr. pasaporte AY2563249, lindur më 05.12.1972 në Athinë, Greqi, shtetas grek, nënkryetar i Këshillit të Administrimit;
 - **Znj. Suela Veli Onal**, me nr. pasaporte BA3844866, lindur më 26.02.1977 në Sarandë, Shqipëri, shtetase shqiptare, anëtare e Këshillit të Administrimit.
- 25.2. Nëse është e nevojshme, Asambleja e Përgjithshme do të konfirmojë çdo emërim të bërë në përputhje me këtë statut në mbledhjen e saj të parë.

Neni 26 – Administratori i parë i Shoqërisë

- 26.1 Administratori i parë i Shoqërisë i emëruar për një mandat 3 (tre) vjeçar është:
1. **Znj. Suela Veli Onal**, me nr. pasaporte BA3844866, lindur më 26.02.1977 në Sarandë, Shqipëri, shtetase shqiptare.
- 26.2 Nëse është e nevojshme, Këshilli do të konfirmojë çdo emërim të bërë në përputhje me këtë nen në mbledhjen e tij të parë.

Neni 27 – Audituesi i parë

- 27.1 Audituesi i parë i Shoqërisë emërohet “PKF ALBANIA” SHPK, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar regjistruar në Shqipëri me numër identifikimi (NUIS) L51413005U dhe seli në adresën



Tiranë, Njësia Bashkiake nr. 7, Rr. "Janos Hunyadi", Apartmenti 9, Shqipëri, Auditues i licensuar me numër license 450, datë 20.02.2015 për një mandat 1 (një) vjeçar. Audituesi mund të ndryshohet në çdo kohë me vendim të Asamblesë së Përgjithshme në zbatim të ligjeve shqiptare.

Neni 28 – Dispozita përfundimtare

- 28.1 Dispozitat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare do të zbatohen për çdo çështje që nuk rregullohet shprehimisht me këtë statut.
- 28.2 Nëse ndonjë dispozitë e këtij statuti është ose bëhet e paligjshme, e pavlefshme ose e pazbatueshme në ndonjë aspekt sipas ligjeve të Shqipërisë, ajo do të konsiderohet e veçuar nga ky statut. Në një rast të tillë, aksionarët do të bëjnë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për ta zëvendësuar atë me një dispozitë të vlefshme dhe të detyrueshme, efekti i së cilës është sa më afër efektit të synuar dhe në rast se nuk arrihet marrëveshje, do të zbatohen dispozitat e zbatueshme të Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

Neni 29 – Hyrja në fuqi

- 29.1. Ky statut do të hartohet në katër kopje origjinale në gjuhën angleze dhe do të përkthehet në gjuhën shqipe dhe do të hyjë në fuqi dhe do të bëhet i detyrueshëm pas nënshkrimit të tij nga Aksionari.

Nënshkruar më 30 Tetor 2023

AKSIONARI I VETËM

Në emër të
Inter Cars S.A.

Nënshkrimi

Nga: Wojciech Twarog, Anëtar i Këshillit të Administrimit

Nënshkrimi

Nga: Jacek Piotrowiak, i autorizuar

SHTOJCA A: ÇËSHTJET E REZERVUARA TË KËSHILLIT

Aktivitetet e Biznesit

1. Hapja e adresave dytësore të biznesit në territorin e Republikës së Shqipërisë.
2. Çdo çështje në të cilën një Anëtar i Këshillit ose Administratori i Shoqërisë është i interesuar ose ku ai ka, ose mund të ketë, një konflikt interesi.

Praktika dhe politikat e biznesit

3. Miratimi ose ndryshimi i çdo politike biznesi të shoqërisë (duke përfshirë politikat në lidhje me mjedisin, punësimin, shëndetin dhe sigurinë).

Punësimi dhe përfitime të tjera

4. Vendimet thelbësore në lidhje me një pjesë thelbësore të fuqisë punëtore të Shoqërisë.
5. Krijimi ose ndryshimi i çdo skeme të bonusit ose skemë tjetër nxitëse të çdo natyre për drejtorët dhe punonjësit e Shoqërisë dhe rekomandimi Asamblesë së Përgjithshme për krijimin ose ndryshimin e çdo opsioni të ndarjes së fitimit, ose për aksione në lidhje me sa më sipër.
6. Krijimi ose ndryshimi i ndonjë skeme pensioni ose dhënia e ndonjë të drejte të skemës së pensioneve për ndonjë drejtor (aktual ose të mëparshëm) ose punonjës të shoqërisë.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER LORIANA A. ROBO**



**DATE 14/11/2023
NR REP 5242**

VËRTETIM PËRKTHIMI

Sot, më datë 14/11/2023, para meje Notere LORIANA A. ROBO, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën NR.5, ISMAIL QEMALI, NR.27, NR.1, NR.1, u paraqit personalisht:

PËRKTHYES:

Daniela Demiri, atësia Myzafer, amësia Drita, shtetase Shqiptare, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANË, me adresë 1001 Njesia Bashkiake Nr. 10 Myslym Shyri 124/2 2 27, lindur më 23/11/1983, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 025734119 dhe nr. personal I36123030B.

Përkthyesja është e licencuar nga Ministria e Drejtësisë, e cila më deklaroi se përktheu me përpikmëri dhe saktësi dokumentin bashkangjitur "Akt themelimi dhe Statuti i shoqërisë Inter Cars Albania Sh.A", nga gjuha angleze në gjuhën shqipe dhe e nënshkroi rregullisht përpara meje Noteres.

Në referim të nenit 135, i ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë"; në Republikën e Shqipërisë unë Noterja vërtetohet nënshkrimi i përkthyeses.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të këtij veprimi, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**NOTER
LORIANA A. ROBO**